


Treguesit demografikë

Tremujori IV – 2025

Tiranë, më 11 Shkurt 2026: Shtesa natyrore e popullsisë për tremujorin e katërt 2025 rezulton pozitive, duke regjistruar 668 lindje më shumë sesa vdekje, ku:

- numri i lindjeve për tremujorin e katërt 2025 është 5.373, duke shënuar një rënie me 10,7 %, krahasuar me tremujorin e katërt 2024;
- numri i vdekjeve për tremujorin e katërt 2025 është 4.705, duke shënuar një rënie prej 12,3 %, krahasuar me tremujorin e katërt 2024.

Fig. 1: Shtesa natyrore e popullsisë




* Të dhëna paraprake

Në tremujorin e katërt 2025, shtatë qarqe të vendit regjistrojnë shtesë natyrore pozitive të popullsisë, ndërsa në pesë qarqet e tjera, shtesa natyrore e popullsisë është negative.

Në tremujorin e katërt 2025, qarku me shtesën natyrore më të lartë është Tirana, me 1.547 lindje më shumë sesa vdekje, ndërsa qarku me shtesën natyrore më të ulët është Fieri, me 120 vdekje më shumë sesa lindje.

Fig. 2: Lindjet, vdekjet dhe shtesa natyrore sipas qarqeve, T4 – 2025*



* Të dhëna paraprake

Lindjet

Në tremujorin e katërt 2025, një qark i vendit regjistron rritje të numrit të lindjeve, ndërsa njëmbëdhjetë qarqe të tjera shënojnë ulje, në krahasim me tremujorin e katërt të vitit 2024.

Qarku Tiranë paraqitet me numrin më të lartë të lindjeve, duke regjistruar 2.589 lindje, ndërsa qarku Gjirokastrë paraqitet me numrin më të ulët, me 70 lindje.

Qarku Tiranë regjistron rritjen më të lartë në përqindje të lindjeve, me 10,4 %, ndërsa rënien më të theksuar e regjistron qarku Dibër, me 38,9 %, krahasuar me tremujorin e katërt 2024.

Tab. 1: Lindjet sipas qarqeve

Nr.	Qarku	2024-4	2025 - 1*	2025 - 2*	2025 - 3*	2025 -4*
	Shqipëria	6.019	4.662	4.982	6.408	5.373
1	Berat	212	169	167	241	152
2	Dibër	283	202	250	247	173
3	Durrës	676	541	528	730	513
4	Elbasan	533	385	434	542	398
5	Fier	494	381	393	557	373
6	Gjirokastrë	91	76	74	81	70
7	Korçë	258	254	230	271	208
8	Kukës	177	138	163	204	131
9	Lezhë	286	208	216	274	209
10	Shkodër	405	299	304	416	343
11	Tiranë	2.346	1.750	1.982	2.509	2.589
12	Vlorë	258	227	212	290	214
	**Të panjohur	0	32	29	46	0

* Të dhëna paraprake

** Kategoria "Të panjohur" nënkupton numrin e lindjeve të gjalla, për të cilat informacioni i qarkut ku është regjistruar lindja mungon.

Vdekjet

Gjatë tremujorit të katërt 2025, numri më i ulët i vdekjeve është regjistruar në qarkun e Kukësit, me 81 raste, ndërsa numri më i lartë në qarkun e Tiranës, me 1.042 raste.

Në tremujorin e katërt 2025, të gjitha qarqet shënuan ulje të numrit të vdekjeve në krahasim me tremujorin e katërt të vitit 2024. Qarku i Korçës shënon rënien më të theksuar të numrit të vdekjeve, me një ulje prej 53,5 %, krahasuar me tremujorin e katërt të vitit 2024.

Tab. 2: Vdekjet sipas qarqeve

Nr.	Qarku	2024-4	2025 - 1*	2025 - 2*	2025 - 3*	2025 -4*
	Shqipëria	5.366	5.545	4.934	5.061	4.705
1	Berat	324	311	250	260	256
2	Dibër	218	195	201	203	148
3	Durrës	437	528	417	477	389
4	Elbasan	514	538	478	505	358
5	Fier	589	612	572	524	493
6	Gjirokastrë	180	160	148	166	150
7	Korçë	497	531	456	487	231
8	Kukës	121	123	119	100	81
9	Lezhë	254	266	227	226	184
10	Shkodër	422	465	409	434	301
11	Tiranë	1.407	1.423	1.291	1.271	1.042
12	Vlorë	403	385	344	376	292
	**Të panjohur	0	8	22	32	780

* Të dhëna paraprake

** Kategoria "Të panjohur" nënkupton numrin e vdekjeve, për të cilat informacioni i qarkut ku është regjistruar vdekja mungon.¹

Për më shumë informacion dhe për të parë tabelat e detajuara, vizitoni bazën e të dhënave në faqen zyrtare të INSTAT: [Treguesit demografikë](https://www.instat.gov.al/sq/temat/treguesit-demografike-dhe-sociale/lindjet-vdekjet-dhe-martesar/#tab4).

¹ Shiko metodologjinë në linkun në vijim: <https://www.instat.gov.al/sq/temat/treguesit-demografike-dhe-sociale/lindjet-vdekjet-dhe-martesar/#tab4>

Metodologjia

Të dhënat tremujore për lindjet dhe vdekjet, në nivel kombëtar dhe qarku, përbëjnë një hallkë të rëndësishme të demografisë së vendit. Ato paraqesin të dhëna mbi ndryshimet në popullsi, të cilat kanë impakt në jetën ekonomike dhe sociale të vendit. Këto të dhëna publikohen mbështetur në Programin e Statistikave Zyrtare 2022-2026.

Lindjet

Të dhënat e lindjeve:

Të dhënat e lindjeve sipas karakteristikave bazë demografike sigurohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, e cila dërgon në INSTAT vetëm numrin e lindjeve të banuesve në Shqipëri. Konsiderohen të gjitha lindjet e banuesve në Shqipëri gjatë periudhës referencë, duke mos marrë parasysh lindjet e banuesve jashtë Shqipërisë (emigrantëve), edhe pse mund të regjistrohen në zyrat e gjendjes civile, pranë ish-vendbanimeve të tyre.

Regjistrimet e vona të lindjeve

Kryhet një rregullim i vogël i numrit të lindjeve që regjistrohen vonë për vitin aktual, në mënyrë që të përfshijmë të gjitha lindjet e ndodhura në periudhën referencë.

Numri i lindjeve të regjistruara vonë nga viti i mëparshëm janë konsideruar si një proxy për regjistrimet e vona të vitit aktual, duke konsideruar supozimin (si rezultat edhe i analizave tona të vazhdueshme) që numri i regjistrimeve të vona të lindjeve nuk ndryshon shumë nga viti në vit.

Vdekjet

Të dhënat e vdekjeve

Të dhënat e vdekjeve, sipas karakteristikave bazë demografike sigurohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, e cila dërgon në INSTAT vetëm numrin e vdekjeve të banuesve në Shqipëri. Konsiderohen të gjitha vdekjet e banuesve në Shqipëri gjatë periudhës referencë, duke mos marrë parasysh vdekjet e banuesve jashtë Shqipërisë (emigrantëve), edhe pse mund të regjistrohen në zyrat e gjendjes civile pranë ish-vendbanimeve të tyre.

Regjistrimet e vona të vdekjeve

Bëjmë një rregullim të vogël të numrit të vdekjeve që regjistrohen vonë për vitin aktual, në mënyrë që të përfshijmë të gjitha vdekjet e ndodhura në periudhën referencë.

Numri i vdekjeve të regjistruara vonë nga viti i mëparshëm janë konsideruar si një proxy për regjistrimet e vona të vitit aktual, duke konsideruar supozimin (si rezultat edhe i analizave tona të vazhdueshme) që numri i regjistrimeve të vona të vdekjeve nuk ndryshon shumë nga viti në vit.

Përkufizime:

Shtesa natyrore e popullsisë: Shpreh rritjen/rënien e popullsisë, si rezultat i proceseve biologjike (lindjeve dhe vdekjeve) të saj, gjatë një periudhe kohe.

Ky tregues shprehet si diferencë ndërmjet lindjeve dhe vdekjeve.

Lindje e gjallë: Lindjet e fëmijëve që shfaqën shenja jete.

Vdekje: Nënkupton zhdukjen e përhershme të të gjitha shenjave të jetës, në çdo kohë pasi ka ndodhur një lindje e gjallë (ndërprerjen e funksioneve vitale, pa aftësinë e ringjalljes).